



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:188714

Datë: 11.03.2025

Numri i dokumentit: 06969143

C.nr.2146/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.S. , të cilën sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson avokat Bedri Miftari, me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës KM - DKA , të cilën sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson Arbnor Murturi, avokat më seli në Prishtinë, me objekt kontesti “*Kompensim i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*”. Vlera e kontestit prej 150.00 Euro, jashtë seancë gjyqësore, më datën 11.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses L.S. , më të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura KM - DKA , që t’ia paguajë kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, dhe atë:
 - në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore), për 75 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), për periudhën nga data 12.03.2020 deri më 31.12.2020, t’ia paguajë shumën e tërësishme prej 150.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë (13.05.2024) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën ligjore) në afatin prej 7 (shtatë) ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- II. DETYROHET paditësja L.S. , që përfaqësuesit të së paditurës, t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 78 (*shatëdhjetë e tetë*) euro, në afat prej 7 (*shtatë*) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja L.S. , nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 13.05.2024, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës KM - DKA , me objekt kontesti *“kompensimin i të ardhurave nga marrëdhënia e punës”*.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejtë se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkëngjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr.2146/2024, të datës 04.11.2024, e detyron të paditurën që në afatin prej 15 ditësh të paraqesë përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike. Tutje, e paditura më parashtrësën e datës 27.11.2024, (përgjigjen në padi) e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë, për shkak të parashkrimit të së drejtës për borxhin në tërësi.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye si në vijim:

Meqenëse paditësja me anë të kërkesëpadisë ka parashtruar kërkesën për të cilën vie në shprehje insituti i së drejtës së punës, gjegjësisht *“institutit i parashkrimit të kërkesave nga marrëdhënia e punës”*, insitut ky në të cilin është thirrur edhe e paditura me anë të përgjigjes në padi, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, duke e refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë, për periudhën nga data 12.03.2020 deri me datën 31.12.2020, ku sipas nenit 87 te Ligjit te Punës është paraparë se *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj, nga koha e krijimit te drejtës për të kërkuar kompensimin e ushqimit gjatë pranisë në punë (shujtave ditore), e deri te paraqitja e padisë për kompensimin e të ardhurave në fjalë, kanë kaluar 3 vite.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK, e cila dispozitë në paragrafin 1 përcakton *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*. Ndërsa, me nenin 4 paragrafi 2 i të njëjtit ligj përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale te shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Në lidhje më afatin për ankesë prej 7 ditësh, Gjykata vendosi në bazë të nenit 476 dhe 477 të LPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452, ashtu që pala paditëse nuk e ka fituar kontestin, ndërsa pala e paditur i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, në rastin konkret paditësi ka për obligim që përfaqësuesit të së paditurës t’ia paguaj shpenzimet procedurale në emër përpilimit të përgjigjjes në padi, dhe atë në shumën prej 78 (*shtatëdhjetë e tetë*) Euro.

Prandaj, gjykata bazuar në arsytet e cekura më lartë si dhe duke u bazuar në nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.2146/2024, datë 11.03.2025

GJYQTARI
Skender Shala

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimiut të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.